



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 229 Prot.

Tiranë, më 23/02/2023

**VENDIM**

Nr. 53, datë 23.02.2023

**PËR FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEVE E DREJTUESËVE  
TË NJËSIVE BAZË NË FAKULTETIN E MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E  
MJEKËSISË, TIRANË**

Në zbatim të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik "Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik të UMT me nr.11, datë 10.02.2023 dhe në Urdhrin të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 27, datë 21.02.2023 "Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor për zgjedhjen e drejtuesve të njësive bazë (Departamenti i kirurgjisë dhe në Departamentin e obsetrikë-gjinekologjisë) në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë", KIZ në mbledhjen e datës 23.02.2023;

**VENDOSI:**

1. Të shpallë fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e Drejtuesve të Njësive Bazë në:
  - a. Departamenti i Kirurgjisë, Fakulteti i Mjekësisë, UMT
  - b. Departamenti i Obsetrikë-Gjinekologjisë Fakulteti i Mjekësisë, UMT
2. Të miratojë periudhën e zhvillimit të procesit zgjedhor nga data 23.02.2023 deri në 24.03.2023 dhe datën 24.03.2023 datën e votimit për zgjedhjen e drejtuesve të njësive bazë sipas pikës 1.
3. Ti kërkojë Fakultetit të Mjekësisë të publikojë dhe shpallë njoftimin për zgjedhjen që do të zhvillohen për drejtuesit e njësive bazë me qëllim realizimin e fushatës së tyre nga kandidatët që do të shfaqin interes për të kandiduar në këto zgjedhje.
4. KZF e Fakultetit të Mjekësisë në UMT, të nisë procedurën e shpalljes dhe të pranimit të aplikimeve të kandidatëve për drejtues të njësive bazë dhe të shpallë listën përfundimtare të

aplikantëve për çdo njësi bazë sipas përcaktimeve të Rregullores së organizimit të zgjedhjeve në UMT.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në mjediset e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT dhe një kopje e tij i dërgohet KZF të Fakultetit të Mjekësisë, UMT.

**KRYETAR**  
**SILVANA BALA**

